



Prishtinë, 27 gusht 2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1272\_2020

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtrithshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve, dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e kompanisë N.T. "LIRIDONI"- Pejë, me kapacitet të instaluar prej **100 kW** në Komunën e Pejës, të datës 23.06.2020 nr. Prot. 257/20 të aplikuesit N.T."LIRIDONI", me adresë: "Pejë", Komuna Pejës, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur më 27 gusht 2020 nxori këtë:**

**V E N D I M**

**PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM**

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit N.T."LIRIDONI", për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, sipas Pëlqimit nr. 08-350-54857 i dt. 06.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, me kapacitet të instaluar prej **100 kW** që do të vendosen mbi objekt të kompanisë N.T."LIRIDONI", në Komunën e Pejës.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi N.T."LIRIDONI", me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPE- 9030628 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtroj kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.



- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimi teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi N.T.“LIRIDONI”, do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimi teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

### Arsyetim

- ZRRE, me datë 23.06.2020 nga aplikuesi N.T.“LIRIDONI”, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, sipas Pëlqimit nr. 08-350-54857 i dt. 06.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit, me kapacitet të instaluar prej **100 kW** që do të vendosen mbi objekt të kompanisë N.T.“LIRIDONI”, në Komunën e Pejës.
  - Aplikuesi, s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 4382 të datës 19.06.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Pëlqimin Nr. 08-350-54857 të datës 06.07.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit, dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Pejës.
  - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit N.T.“LIRIDONI”, dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **100 kW** që do të vendosen mbi objekt të kompanisë N.T.“LIRIDONI”, në Komunën e Pejës, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

